



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax 04 22268141; 22268142

Nr. 295/10 Prot.

Tiranë, më 10.11.2017

V E N D I M

Nr.231, datë 10/11/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 133, datë 13.06.2017, "Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës **", protokolluar pranë Komisionerit me nr. 295 prot., datë 21.04.2017", në institucionin e Bashkisë Pogradec"***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 133, datë 13.06.2017, "Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës *****", protokolluar pranë Komisionerit me nr. 295 prot., datë 21.04.2017", në institucionin e Bashkisë Pogradec,

Vërejtje:

Bazuar në informacionin e marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës *****, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 295 prot., datë 21.04.2017, ka nisur verifikimi në Bashkinë Pogradec. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 133, datë 13.06.2017, "Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës *****", protokolluar pranë Komisionerit me nr. 295 prot., datë 21.04.2017", në të cilin është vendosur:

"1. Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe njësia përgjegjëse, pranë Bashkisë Pogradec, të shfuqizojnë aktin administrativ nr. 205, datë 28.04.2017, për transferimin e përkohshëm për një periudhë 6-mujore të punonjësës **", nga pozicioni "Drejtor" në Drejtorinë e Punëve Publike, pranë Bashkisë Pogradec, në pozicionin "Specialist për***

Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, në Njesisë Administrative Trebinjë, pranë Bashkisë Pogradec, si akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin.

2. Të rregullohen pasojat e krijuara nga ky akt administrativ, në dëm të nëpunëses civile duke e rikthyer atë në pozicionin e saj të mëparshëm të punës.

*3. Të njoftohen për këtë vendim, Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe njësia përgjegjëse e institucionit, si dhe nëpunësja *****.*

4. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër, institucionit i lihet afat, 15 ditë.

5. Me kalimin e këtij afati, duhet të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mënyrën e zbatimit të vendimit.

6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjatimit të nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 133, datë 13.06.2017, “*Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës ******, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 295 prot., datë 21.04.2017”, me Urdhrin nr. 295/6 prot., datë 08.09.2017, “*Për verifikimin e zbatimit të Vendimit Nr. 133, datë 13.06.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil*”, ka filluar verifikimin e zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, i cili në datën 18.09.2017, u paraqit në institucion. Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Bashkisë Pogradec dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 295/7 prot., datë 08.09.2017, “*Njoftim për fillimin e verifikimit*”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në institucion komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore, të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqëruar që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit, është materializuar në procesverbalin e datës 18.09.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personi i kontaktit të institucionit të Bashkisë Pogradec.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore të vëna në dispozicion, rezultoi se:

- Në dispozitivin e vendimit objekt verifikimi, në pikën 1 dhe 2 të tij, Komisioneri ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe njësia përgjegjëse të shfuqizojnë aktin administrativ nr. 205, datë 28.04.2017, për transferimin e përkohshëm për një periudhë 6-mujore të punonjësës ***** nga pozicioni “Drejtor” në Drejtorinë e Punëve Publike, pranë Bashkisë Pogradec, në pozicionin “Specialist për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, në Njesisë Administrative Trebinjë, pranë Bashkisë Pogradec, si akt të nxjerrë në kundërshtim me ligjin, pasi referuar pikës 1, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikës 2, Kreu I, të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, përcaktohet se: “nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori....”.

Grupi i punës, gjatë verifikimit në institucion konstatoi se kjo detyrë nuk ishte përmbushur, fakt ky i vërtetuar nga mungesa e emrit të punonjësës ***** në listëprezencën e muajit gusht 2017 të Bashkisë Pogradec.

Në vijim, me shkresën nr. 2220/1 prot., datë 22.09.2017, “Kthim përgjigje”, titullari i institucionit të Bashkisë Pogradec ka informuar Komisionerin për rikthimin e punonjësës ***** në pozicionin “Drejtor” i Drejtorisë së Infrastrukturës, Transportit dhe Punëve Publike pranë Bashkisë Pogradec, shkëputjen e marrëdhënieve financiare më datë 02.10.2017, nga pozicioni i punës “Specialist për administrimin dhe mbrojtjen e tokës” dhe fillimin e marrëdhënies financiare në pozicionin “Drejtor” më datë 02.10.2017 (bashkëlidhur shkresës ndodhet Vendimi nr. 527, datë 20.09.2017, “Për rikthimin e ***** në pozicionin Drejtor”, i cili materializon zbatimin e vendimit objekt verifikimi).

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 133, datë 13.06.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës *****, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 295 prot., datë 21.04.2017”, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njesisë së burimeve njerëzore të institucionit të Bashkisë Pogradec janë zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit Nr. 133, datë 13.06.2017, *“Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës *****”, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 295 prot., datë 21.04.2017”,* në Bashkinë Pogradec.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit, Bashkia Pogradec, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 133, datë 13.06.2017.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Bashkia Pogradec dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA